

Programi i Unionit Evropian "IPA II" për "Kosovën"

Produkti D1.1.3

# **TeR për Koordinatorin Nacional AT/Zyra e Koordinatorit Nacional AT**

"Lëvizja Përpara:

Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit më të madh në  
luftë kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë"



Projekt i Financuar nga BE dhe i menaxhuar  
nga zyra e BE në Kosovë



KINDLING A BETTER WORLD

Projekt i implemetuar nga  
Family and Childcare Centre  
(KMOP)



Kontrata Nr:  
2016/382-826

# TeR për Koordinatorin Nacional AT/Zyra e Koordinatorit Nacional AT



INSTRUMENTI PËR ASISTENCË PARA PRANIMIT (IPA II)  
Vija Buxhetore: BGUE-B2014-22.020101-C1-ELARG DELKOS  
Referenca: EuropeAid/150787/DD/ACT/XK

**“LËVIZJA PËRPARA: PROMOVIMI I EFIKASITETIT DHE EFEKTIVITETIT  
MË TË MADH NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE  
NË KOSOVË”**

**NUMRI I KONTRATËS: 2016/382-826**

Produkti D1.1.3

TeR për Koordinatorin Nacional AT/Zyra e Koordinatorit Nacional AT

Informata të dokumentit

Data e caktuar e dorëzimit	31/08/2017
Data e dorëzimit aktual	02/11/2017
Emri i organizatës dhe kontraktorit Lider për këtë produkt	KMOP
Revizioni	2.0

Niveli i Shpërndarjes

PU	Publik	
PP	I Kufizuar për pjesëmarrësit e programit (përfshirë shërbimet e komisionit)	
RE	I Kufizuar për grupin e specifikuar nga Konzorciumi (përfshirë shërbimet e komisionit)	
CO	Konfidencial, vetëm për anëtarët e konzorciumit (përfshirë shërbimet e komisionit)	

Lista e Autorëve	
Autor	Partner
Blerta Perolli-Shehu	KMOP
Antigona Dajakaj	KMOP
Rishikuesit	
Rishikuesi	Partneri
Antonia Torrens	KMOP
Vassia Karkantzou	KMOP
Alexandra Koufouli	EPLO
Effie Liristi	EPLO
Hamijet (Keti) Dedolli	PVPT
Gresa Kelmendi	PVPT
Verziori	
Verziori	Përmbledhja
1.0	Zhvillimi i Draft verzionit v01
2.0	Zhvillimi i Verzionit Final

Projekti është i financuar me përkrahjen me e Komisionit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si reflektim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>6</b>
<b>2. INFORMATA MBI KNAT/ZKNAT NË KOSOVË .....</b>	<b>7</b>
a. Detyrat dhe përgjegjësit e KNAT/ZKNAT .....	7
<b>3. FUNKSIONIMI I ZYREVE TË KNAT NË REGJION .....</b>	<b>14</b>
a. Shqipëria .....	14
b. Maqedonia .....	15
c. Sërbia .....	16
<b>4. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>17</b>
<b>5. Referencat.....</b>	<b>20</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Kuptimi
TeR	Termet e Referimit
KNAT	Koordinatori Nacional Anti-Trafikim
ZKNAT	Zyra e Koordinatorit Nacional Anti-Trafikim
AT	Anti-Trafikim
KMOP	Qendra për Kujdesin Familjar dhe të Fëmijëve
MNR	Mekanizmi Nacional i Referimit
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
TQNJ	Trafikimi i Qenjeve Njerëzore
EPLO	Organizata Evropiane për Ligjin Publik
PVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
TiT	Trainimi i Trajnerëve

## 1. HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore është njohur si një formë e krimit të organizuar i lidhur ngushtë me forma tjera të ndryshme, duke rrezikuar sigurinë Nacionale dhe ekonominë e secilit vend. Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha përpjekjet e Qeverisë së Kosovës ndaj kësaj janë përshkruar në Strategjinë Nacionale kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë 2015-2019. Kjo strategji koordinohet, zbatohet dhe monitorohet nga Autoriteti Nacional kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i cili kryesohet nga Koordinatorin Nacional Anti-Trafikim.

Ky produkt u përgatit në kuadër të projektit të financuar nga BE "Lëvizja Përpara", me synim të përcaktimit të nevojave si dhe analizimin e kufizimeve të TeR për ZKNAT në zbatimin e suksesshëm të Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNJ) 2015-2019 si dhe në funksionimin e Mekanizmit Nacional të Referimit (MKR) dhe zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit (PSV), duke paraqitur gjithashtu rekomandime për përmirësim. Përmbledh një rishikim të Termeve aktuale të Referimit për Koordinatorin Nacional të Trafikimit (KKNAT) dhe Zyrës së Koordinatorit Nacional Anti-Trafik (ZKNAT), sipas mandatit të Ligjit Nr. 04 / L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

Plani fillestar në lidhje me këtë arritje ishte që zyrtarët të vendosin Termet e Referimit të ZKNAT (Sekretariati i AT) dhe në përputhje me këtë të punojnë drejt formalizimit të tyre, duke pasur parasysh se sa i përket njohurive të ekipit të projektit ato nuk ekzistojnë. Sidoqoftë, pas disa konsultimeve me përfituesin pas përfundimit të fazës fillestare të projektit, është konsideruar më e përshtatshme të bazohet kjo punë në legjislacionin në fuqi, duke pasur parasysh se Ligji nr. 04/L-218 përshkruan mandatin për KNAT dhe për zgjerimin e Zyrës së tij (ZKNAT, gjithashtu i njohur si Sekretariati). Prandaj, ekipi i projektit zgjati analizën dhe periudhën e hartimit të këtij aktiviteti në mënyrë që të mund të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse lidhur me mandatin e vetë KNAT/ZKNAT (siç është përcaktuar në Ligj) së bashku me analizën e strukturave dhe organizimin e autoriteteve të ngjashme në rajon, në mënyrë që të dalë me rekomandime të dobishme për rregullim më të mirë të brendshëm të Sekretariatit.

Një analizë e mandatit aktual të KNAT është paraqitur në Seksionin 2.a më poshtë, pasuar nga analiza e strukturave të autoriteteve të ngjashme në vendet fqinje, përkatësisht Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë (Seksioni 3).

## 2. INFORMATA MBI KNAT/ZKNAT NË KOSOVË

Struktura e KNAT dhe Zyrës përkatëse (ZKNAT) u prezantua në Tetor 2003, në të njëjtën kohë kur u krijua grupi i parë ndërministror i punës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë në nivel Nacional. Emërimi i Kryetarit të Grupit Punues kundër Trafikimit u delegua në Zyrën për Qeverisje të Mirë nën Zyrën e Kryeministrit. Grupi punues ka qenë i mandatuar të hartojë për herë të parë Raportin mbi gjendjen e trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Kosovës. Në Dhjetor 2004, Zyra e Kryeministrit të Kosovës themeloi Sekretariatit Nacional për Koordinatorin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Në Maj 2005, Qeveria e Kosovës caktoi Drejtorin e Zyrës për Qeverisje të Mirë si Koordinator Nacional për Anti-Trafikimin në Republikën e Kosovës dhe mandati i parë i KNAT/ZKNAT u formalizua në bazë të nenit 9.3.16 të UNMIK-ut Rregullorja nr. 2001/9 të Kornizës Kushtetuese/Institucioneve të Përkohshme Qeveritare të Kosovës, neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut nr.2001 / 19.

Me vendimin e Kryeministrit nr. 29, në Prill të vitit 2008, Zyra e Kryeministrit të Kosovës e caktoi Zëvendësministrin e Punëve të Brendshme të jetë Koordinator Nacional të Anti-Trafikimit të Kosovës.

Ligji nr. 04/L-218, krijon mekanizmin e Autoritetit Nacional Antitrafikim që përbëhet nga të gjitha institucionet e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikuara, si dhe institucioneve të tjera shtetërore relevante, duke përfshirë përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve lokale si dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare. Autoriteti Nacional, në kuadër të Strategjisë Nationale dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit të Njerëzve, Procedurat Standarde të Veprimit për viktimat e trafikimit, standardet minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit dhe të gjitha dokumentet tjera relevante, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion në parandalimin dhe luftimin e TQNJ dhe mbrojtjen e viktimave për të mundësuar luftën efektive kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe ndihmën në kohë dhe në mënyrë efikase si dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në Kosovë, siç përcaktohet nga mandati legjislativ i secilit institucion. Institucionet që janë anëtare të Autoritetit përfshijnë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatat, Prokurorin e Shtetit, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shoqërinë Civile, donatorët, etj. Autoriteti mbledhet periodikisht dhe në bazë të nevojave ad-hoc. Ekzistojnë nën-grupe të themeluara dhe të organizuara varësisht nga natyra e çështjeve të shqyrtuara ose të diskutuara.

### a. Detyrat dhe përgjegjësit e KNAT/ZKNAT

Për qëllimet e këtij produkti, ne do të kalojmë nëpër secilën prej detyrave të përcaktuara dhe do të përpiqemi të bëjmë ndarjen se çfarë nënkupton kjo për ZKNAT dhe cilat janë kërkesat për përfundimin e suksesshëm të atyre detyrave.

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-218, i miratuar në Shtator të vitit 2013, është detyrë e Qeverisë së Kosovës që të emërojë Koordinatorin Nacional Antitrafikim, i cili kryeson Autoritetin Nacional dhe bashkëpunon rregullisht me anëtarët e Autoritetit Nacional me qëllim të parandalimit dhe luftën kundër



trafikimit të qenieve njerëzore si dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Detyrat dhe përgjegjësitë e KNAT dhe Zyrës së tij janë dhënë në terme të përgjithshme në nenin 8 të Ligjit të lartpërmendur.

Tabela më poshtë, kolona në të majtë paraqet seksionet e nenit 8 që përshkruajnë përgjegjësitë e KNAT/ZKNAT, ndërsa kolona në të djathtë paraqet vërejtjet dhe aty ku është e nevojshme, rekomandimet e ekipit të projektit. Për referencë më të lehtë, lexuesi duhet të vërej se disa nën-nene të nenit 8 janë të qarta dhe të përcaktuara mirë, dhe ndonëse nuk konsiderohen të nevojshme, rekomandimet konkrete, është dhënë një përshkrim i detajuar dhe i përpunuar i detajeve të veçanta. Në raste të tjera, rekomandimet për modifikim paraqiten sipas nevojës.

<i>Sikur që është për caktuar në ligj</i>	<i>Vëzhgimet dhe Rekomandimet e ekipit të Projektit</i>
<p>Neni 8.3: Koordinatorit dhe Sekretariati i Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive Nacionale (tani i njohur si ZKNAT), zhvillojnë, koordinojnë dhe monitorojnë zbatimin e Mekanizmit Nacional të Referimit (MNR). Sipas Ligjit, MNR është definuar si një kornizë bashkëpunuese përmes të cilës institucionet shtetërore përbushin detyrimet për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e viktimave të trafikimit dhe për të bashkërenduar përpjekjet e tyre në një partneritet strategjik me shoqërinë civile. Kjo detyrë e KNAT/ZKNAT shpjegohet në dispozitën ligjore dhe përcakton qartë përgjegjësinë kryesore për zbatimin e MNR në KNAT dhe Zyrën e tij.</p>	<p>1. Pjesa e parë thotë se Zyra, nën koordinimin e KNAT, është përgjegjëse për zhvillimin e MNR. Me qëllim të kuptimit më të mirë të kësaj detyre, ne propozojmë të përmbledhim në detaje "çfarë" nënkupton zhvillimi i MNR brenda vendit për ZKNAT, dmth.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmarrja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të natyrës dhe shtrirjes së trafikimit të qenieve njerëzore në vend, nëpërmjet shqyrtimit të të dhënave dhe statistikave në dispozicion,</li> <li>• Rishikimin e gjendjes në nivel nacional,</li> <li>• Analiza e instrumenteve dhe mekanizmave ekzistuese,</li> <li>• Vlerësimi i kuadrit ligjor,</li> <li>• Vlerësimi i akterëve dhe strukturave të përfshira.</li> </ul> <p>Ky vlerësim është ndërmarrë në mënyrë që të ketë një pasqyrë të plotë të nevojave dhe situatës; për të përcaktuar kushtet, kërkesat dhe akterët e mundshëm; si dhe për të përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e mundshme brenda MNR, në mënyrë që një strukturë specifike e MNR të zhvillohet në përputhje me rrethanat.</p> <p>Kjo nënkupton që ZKNAT duhet të ketë ekspertizë të brendshme analitike dhe kërkimore për të qenë në gjendje të përmbushë detyrën e kërkuar me cilësi dhe efikasitet.</p> <p>2. Pjesa e dytë thotë se Zyra, nën koordinimin e KNAT, është përgjegjëse për Koordinimin e MNR-së, që nënkupton që ZKNAT është pika qendrore për koordinimin e të gjitha veprimeve në lidhje me MNR. Për qëllim të kuptimit më të mirë të kësaj detyre, ne</p>

propozojmë të përmbledhim në detaje "çfarë" nënkupton Koordinimi i MKR brenda vendit për ZKNAT, dmth.

- a. Organizimi i takimeve të rregullta koordinuese me Autoritetin Nacional, si dhe takimet e rregullta (gjysmëvjetore ose vjetore)/tryeza të rrumbullakëta së bashku me të gjithë akterët kryesorë të përfshirë në reagimin ndaj trafikimit;
- b. Krijimi i rrjeteve midis strukturave lokale, rajonale dhe Nacionale për të mundësuar shpërndarjen efikase të informative dhe mekanizmat e reagimit;
- c. Vendosjen e marrëveshjeve së bashkëpunimit me agjencitë qeveritare dhe joqeveritare të përfshira në procesin e referimit;
- d. Sigurimi i komunikimit në baza të rregullta me palët e tjera të interesit për çështjet që kanë të bëjnë me hartimin dhe zhvillimin e MNR-ve;
- e. Mbledhjen e përditësimeve të rregullta mbi shërbimet ekzistuese të mbështetjes dhe mbrojtjes;
- f. dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, duke siguruar përmbushjen e kërkesave për ndërtim të kapaciteteve dhe trajnimit. Kjo pikë e fundit është veçanërisht e rëndësishme në drejtim të përforcimit të kapacitetit të palëve për të kuptuar dhe adresuar trafikimin njerëzor. Për të siguruar këtë, ZKNAT është përgjegjëse për të ndërmarrë Vlerësimin e Nevojave për Ngritjen e Kapaciteteve dhe si rrjedhim të hartojë dhe ofrojë trajnime për lloje të ndryshme të palëve të interesuara.

3. Kjo përsëri nënkupton që ZKNAT ka nevojë për kapacitete specifike - organizative, kapacitete të personelit, komunikimit etj. - të jetë në gjendje të koordinojë të gjitha këto detyra dhe ekspertizën specifike për të zhvilluar dhe ofruar veprime për ngritjen e kapaciteteve. Pjesa e fundit thotë se Zyra, nën koordinimin e KNAT, është përgjegjëse për të monitoruar zbatimin e MNR, e cila është e detajuar për identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, përfshirë viktimat fëmijë dhe për tu siguruar që ata marrin ndihmë adekuate duke mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore. Për qëllim të kuptimit më të mirë të kësaj detyre, ne propozojmë të përmbledhim në detaje "çfarë" nënkupton Koordinimi i MNR brenda vendit për

	<p>ZKNAT, dmth.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i zbatimit të MNR</li> <li>• Organizimi i takimeve të rregullta për të vlerësuar progresin në identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave (shqyrtimi i vonesave të mundshme, zonave problematike, hapat dhe masat që janë kompletuar etj.),</li> <li>• Përdorimi i të dhënave dhe vëzhgimeve nga monitorimi dhe vlerësimi për të përgatitur propozime për çdo adaptim të nevojshëm në MNR.</li> </ul> <p>krijimi i një mekanizmi të kontrollit të brendshëm që do të menaxhohet nga ZKNAT që do të vendoste bazën për raportim efektiv mbi obligimet e shtetit.</p>
<p>Neni 8.4 i Ligjit, thotë se është përgjegjësi e Qeverisë të sigurojë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për Koordinatorin, Autoritetin Nacional dhe Sekretariatit për të kryer këto aktivitete:</p>	
<p>Neni 8.4.1: koordinimin e zbatimit të këtij ligji, duke përfshirë hartimin e udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore që do të miratohen nga Qeveria;</p>	<p>Kjo është një detyrë shumë e përgjithshme dhe e gjerë por që megjithatë kërkon ekspertizë të veçantë. Vërejtja jonë është se kjo detyrë është shumë ambicioze për ZKNAT-in dhe jashtë fushës së veprimit të tyre.</p> <p>Ne do të propozojmë që brenda vendit detyra të atribuohet departamentit ligjor në Ministri dhe/ose strukturave të tjera të Qeverisë, ndërsa roli i ZKNAT të ngushtohet në "ofrimin e informacionit, inpleteve, ekspertizës dhe/ose rekomandimeve për zbatimin e ligjit dhe për hartimin e udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore që do të miratohen nga qeveria. Përgjegjësia e ZKNAT-it në këtë pikë do të ishte informimi i vendimmarrësve në këtë drejtim, dhe të mos jetë përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të këtij procesi.</p>
<p>Neni 8.4.2.: hartimin dhe zbatimin e vazhdueshëm të Strategjisë Nationale dhe Planit të Veprimit, i cili përmban një pako gjithëpërfshirëse të masave për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të tij;</p>	<p>Kjo është një detyrë e përshkruar në detaje dhe specifike për Strategjinë Nationale dhe Planin e Veprimit. Megjithatë, siç qëndron tani, nënkupton se kjo është një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e ZKNAT. Procesi i hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit është një proces pjesëmarrës që përfshin të gjithë Autoritetin Kombëtar dhe palët tjera relevante të interesuara dhe të koordinuara nga ZKNAT. Në këtë rast, ZKNAT duhet të fokusohet në koordinimin e procesit të hartimit dhe zbatimit të vazhdueshëm të strategjisë dhe të propozojë ndryshime dhe përmirësime në sistemin dhe</p>

	<p>mekanizmat e Strategjisë Kombëtare, si dhe të këshillojë mbi hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e Strategjisë. Kjo nënkupton që ZKNAT të koordinojë procesin dhe të ndjekë zbatimin përmes grumbullimit dhe monitorimit të rregullt të të dhënave, dhe në bazë të kësaj, të sigurojë të dhëna për ndryshime dhe përmirësime.</p>
<p>Neni 8.4.3: promovimin e hulumtimeve dhe përcaktimin e procedurave për të analizuar shkallën, natyrën dhe format e reja të trafikimit lokal dhe ndërkufitar, si dhe identifikimin e praktikave më të mira për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit, duke përfshirë mbledhjen e informacionit mbi numri i viktimave të ndara sipas gjinisë dhe të dhënave të tjera të rëndësishme për të analizuar shkallën, natyrën dhe formën e trafikimit;</p>	<p>Ky nen është kombinim i disa detyrave.</p> <p>Pjesa e parë e nenit fokusohet në promovimin dhe kryerjen e studimeve kërkimore mbi tendencat, situatën, identifikimin e praktikave më të mira dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit - është një pjesë e rëndësishme e detyrave të përgjithshme të ZKNAT-it për të ndjekur situatën e zbatimit të MNR-ve, si dhe të shërbejë si një organ këshillimor për qeverinë e politikave të nevojshme dhe akteve ligjore që duhen hartuar. Lehtësimi dhe promovimi i studimeve të ndërlidhura me TQNJ në bashkëpunim me donatorët, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, institutet kërkimore dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm është gjithashtu një detyrë thelbësore për tu konsideruar nga ZKNAT. Siç thuhet edhe në këtë dokument, kjo do të nënkuptonte rritjen e kapaciteteve, aftësive analitike dhe ekspertizës brenda ZKNAT për të kryer studime kërkimore. Dhe meqë kjo propozohet të jetë një detyrë e rregullt e ZKNAT, burimet nga jashtë nuk konsiderohen të mjaftueshme. Përkundrazi, punësimi i personelit të profilit profesional për hulumtim është shumë i rekomanduar.</p> <p>Pjesa e dytë e nenit nënkupton administrimin dhe mirëmbajtjen e një Sistemi të Menaxhimit të të Dhënave për mbledhjen e informative mbi treguesit e ndryshëm të përcaktuar në planin e veprimit, të bashkuara me masa specifike për të analizuar shkallën, natyrën, formën dhe trendët e trafikimit. Dhënia e politikës së bazuar në dëshmi përmes grumbullimit dhe analizimit të të dhënave konsiderohet të jetë një nga detyrat më të rëndësishme të ZKNAT.</p>
<p>Neni 8.4.4: lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve dhe akterëve të ndryshëm qeveritarë dhe midis akterëve</p>	<p>Kjo është një detyrë e përcaktuar mirë. Ne propozojmë që të shtohet një fjali shtesë për të përcaktuar "si" mund të arrihet kjo, gjegjësisht lehtësimin e bashkëpunimit ....</p>

<p>qeveritarë dhe joqeveritarë, duke përfshirë inspektorët e punës, Odën Ekonomike të Kosovës dhe palët e tjera relevante të tregut të punës;</p>	<p>nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• organizimi i takimeve të rregullta të koordinimit/ tryezave të rrumbullakëta së bashku me të gjithë akterët kryesorë të përfshirë,</li> <li>• Sigurimi i shkëmbimit dhe shpërndarjes së rregullt dhe efikas të informatave,</li> <li>• Sigurimi i komunikimit në baza të rregullta me akterë të tjerë;</li> <li>• Organizimi i ngjarjeve të përbashkëta,</li> </ul> <p>Ndërlidhja në mes të palëve të interes, etj.</p>
<p>Neni 8.4.5: lehtëson bashkëpunimin ndërmjet vendeve të origjinës, tranzit dhe atyre destinuese</p>	<p>Sikurse pika më lartë, ne propozojmë që të shtohet një fjali shtesë për të përcaktuar se "si" kjo mund të arrihet, gjegjësisht të lehtësojë bashkëpunimin .... nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mirëmbajtjen e komunikimit të rregullt me Zyrat e Koordinatorëve Nacional në vendet e origjinës, transitit dhe destinacioneve;</li> <li>• Ndarja e të dhënave, informatave, planeve të veprimit ndërmjet vendeve;</li> </ul> <p>organizimi i ngjarjeve - konferencave të përbashkëta, seminare, shënimin e ditëve ndërkombëtare, takime ballë për ballë së paku një herë në vit.</p>
<p>Neni 8.4.6: vepron si pikë qendrore për institucionet nacionale dhe palët e tjera shtetërore dhe jo shtetërore, si dhe organet ndërkombëtare, në lidhje me përpjekjet e qeverisë kundër trafikimit të qenieve njerëzore</p>	<p>Kjo është një detyrë e përcaktuar mirë, edhe pse detyra konsiderohet se pritët nga ZKNAT në mënyrë të paracaktuar, dhe ne kemi vërejtur se kjo nuk duhet të përcaktohet si detyrë individuale. Mund të ofrohet si informacion i përgjithshëm, në vend që të përcaktohet si një nen i veçantë.</p>
<p>Neni 8.4.7: duke u siguruar që masat kundër trafikimit janë në përputhje me normat ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të cilat janë parashikuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e tjera përkatëse.</p>	<p>Kjo është një detyrë e përcaktuar mirë, edhe pse ne do të propozonim që ajo të mos specifikohet si një nen i veçantë, por më tepër i integruar në nenin mbi zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë, ose nenin e përgjithshëm mbi zbatimin e MNR.</p> <p>Megjithëse konsiderohet si një përgjegjësi e ZKNAT-it në parim, ne konsiderojm si të domosdoshme që kjo të jetë e përcaktuar në ligj.</p>

Një nga rezultatet kryesore të angazhimit afatgjatë të Kosovës në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore janë Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë (PSV), të hartuara së pari në vitin 2004 dhe më vonë të rishikuara dhe të miratuara në vitin 2013. Procedurat Standarde të Veprimit të Aprovuara për Trafikimin Personat në Kosovë (PSV) ofrojnë udhëzime për të gjitha palët e përfshira, nga referimi fillestar deri në procedurat civile ose penale dhe si të tillë ato udhëheqin akterët antitrafikim shtetëror dhe jo shtetëror mbi mënyrën e sigurimit të mbrojtjes së duhur dhe ndihmës ndaj viktimave të mundëshme /viktimave të supozuara. Aktivitetet koordinuese, monitoruese dhe raportuese për zbatimin e PSV-ve janë përgjegjësi e ZKNAT, megjithatë ato nuk janë të përcaktuara në ligj, prandaj ne do të propozojmë një seksion të veçantë të brendshëm për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve për zbatimin e PSV-ve.

Rekomandimet e dhëna në tabelën e mësipërme shërbejnë për të detajuar më tej punën e ZKNAT dhe për të siguruar bazën për zhvillimin e një rregulloreje të brendshme ose Udhëzuesit "Si –Të" brenda ZKNAT për të kuptuar më mirë se çfarë përcakton secili nen, si mund të bëhet kjo dhe si është më së miri të shpërndahen detyrat dhe përgjegjësitë brenda Sekretariatit.

Siç është evidente, ka një numër të madh të detyrave që duhet të kryhen, shumica e të cilave janë profesionale dhe të përshtatura për kualifikime specifike të kërkuara për të qenë në gjendje të kryejnë me sukses detyrën. Përveç faktit se numri dhe profili i stafit në ZKNAT nuk është i mjaftueshëm për të kryer këto detyra, siç është përshkruar më parë, Qeveria e Kosovës emëron zëvendësministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) - KNAT, duke mbuluar detyra të tjera përveçse të jetë KNAT.

Ekzistojnë ngjashmëri me këtë praktikë në Rajon, në kuptimin që përgjegjësia kryesore për veprimet antitrafikim është me Zëvendësministrin, megjithatë ky pozicion ndiqet nga pozita profesionale që sigurojnë zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive. Përveç kësaj, pozicioni i Zëvendësministrit është një pozicion politik dhe kjo potencialisht mund të jetë një kërcënim për angazhimin në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit dhe qëndrueshmërinë e veprimeve të kërkuara nga Zyra dhe Autoriteti për shkak të ndryshimeve në arenën politike që rrjedh nga zgjedhjet, posaçërisht në Kosovë, me zgjedhje të shpeshta dhe ndryshime qeveritare.

### 3. FUNKCIONIMI I ZYREVE TË KNAT NË REGJION

Një analizë e organizimit dhe strukturës së autoriteteve të ngjashme në vendet fqinje, përkatësisht Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi. Vendet u përzgjedhën për shkak të afërsisë me Kosovën dhe bashkëpunimin e shpeshtë në çështjet antitrafikim.

Është vërejtur se të gjitha këto vende, përfshirë Kosovën, kanë zhvilluar Strategjitë Nacionale dhe Planet e Veprimit kundër TQNJ dhe janë pjesë e një rrjeti më të gjerë të palëve të interesuara që luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore. Secili shtet ka krijuar një autoritet/organ ndërmintor në nivel strategjik, i cili përbëhet nga përfaqësues të ministrive të ndryshme relevante dhe palëve të tjera të interesit. Detyrimet dhe përgjegjësitë kryesore të këtyre organeve ndërmintore përfshijnë:

- monitorimin e përgjithshëm të situatës së trafikimit të qenieve njerëzore në vendin e tyre dhe në rajon;
- koordinimi i të gjitha veprimeve Nacionale dhe rajonale kundër trafikimit;
- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive dhe planeve të veprimit Nacionale kundër trafikimit; dhe
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me palët e interesit.

Më poshtë paraqesim shkurtimisht strukturat e organizuara në tre vende fqinje, sipas informacioneve në dispozicion për qasje në internet dhe "offline".

#### a. Shqipëria

Zyra e KNAT në Shqipëri, ngjashëm me Kosovën, është pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe pozita mbahet nga Zëvendësi i Ministrit. Si Zyrë është themeluar dhe funksionalizuar në vitin 2005, me qëllim të koordinimit dhe monitorimit të zbatimit të Strategjive Nacionale për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Një vështrim në detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Nacional zbulon ngjashmëri me atë të Kosovës, përkatësisht si ato në vijim:

- përgatit Strategjinë Nacionale për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Strategjinë Nacionale për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve në konsultim të ngushtë me organizatat strehuese dhe grupet e tjera të shoqërisë civile;
- monitoron veprimtarinë e institucioneve të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Nacionale për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore;
- monitoron zbatimin e Mekanizmit Nacional të Referimit, i cili identifikon, mbron dhe asiston viktimën;
- koordinon Task-forcën Nacionale, Komitetet Regjionale dhe Koalicionin e strehimoreve;
- menaxhon me bazën e të dhënave për Viktimat e Trafikimit dhe i dorëzon raporte përmblendhëse Qeverisë;
- përcjellë dhe i raporton Qeverisë të gjitha çështjet të lidhura me trafikimin;
- Propozon amendamente legislative apo alokime specifike të fondeve në buxhetin shtetërorë;

- Inkurajon ngritjen e transparencës së aktiviteteve të institucioneve shtetërore me qëllim të ngritjes së vetëdijes në këtë fushë, duke kooperuar me institucione të tjera dhe shoqërinë civile në këto çështje.

Megjithëse detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme janë të ngjashme me KNAT në Kosovë, ka dallime të mëdha në strukturimin dhe funksionimin e zyrës. Pozita mbahet nga zëvendësministri i MPB-së në Shqipëri, megjithatë Zyra e KNAT-it punëson një drejtor me orar të plotë të njësisë antitrafikim, i cili mbështetet nga 4 koordinatorë me përshkrime të ndryshme të vendeve të punës në varësi të fushës që ata mbulojnë. Pozita e Drejtorit mbahet nga një person i cili nuk ka sfond politik, por më tepër një profil profesional me arsimim të dëshmuar dhe përvojë në çështjet antitrafikim. Në Shqipëri, personi në këtë pozitë ka qenë aktiv që nga mesi i vitit 2013.

Dallimi tjetër, është se ZKNAT në Shqipëri gjithashtu koordinon strukturat rajonale dhe komunale në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Komitetet Rajonale për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore u krijuan në vitin 2006 me qëllim të monitorimit dhe koordinimit të punës së të gjithë partnerëve (institucioneve shtetërore dhe OJQ-ve) në nivel rajonal, duke përfshirë Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve Sociale Shtetërore, Policinë e Trafikimit, Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe Drejtorinë Rajonale të Shëndetit. Në nivel komunal, ekzistojnë Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF) të përbëra nga specialistë të mbrojtjes së fëmijëve që i përkasin agjencisë së ndihmës sociale dhe shërbimeve të komunave. Akterët rajonal dhe lokal janë pjesë aktive e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve, pasi që në Shqipëri ka një strategji specifike për fëmijët. Sipas kërkesave të strategjisë, ata raportojnë periodikisht në ZKNAT në Shqipëri për zhvillimet në territoret e tyre.

ZKNAT në Shqipëri publikon rregullisht një revistë tremujore me informata mbi aktivitetet e zyrës dhe të dhënat relevante të mbledhura dhe të analizuar.

Këto konsiderohen praktika të mira që duhen marrë në konsideratë për funksionimin dhe strukturimin e Zyrës së KNAT në Kosovë.

## b. Maqedonia

Në Maqedoni, Zyra e Koordinatorit Nacional u themelua në vitin 2005 në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale me qëllim të ofrimit të mbështetjes teknike dhe logjistike të Komisionit Nacional për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm. Koordinatori Nacional është Sekretar Shtetëror në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Megjithatë, Komisioni Nacional, i cili është organi ndërmintor i përbërë nga 17 përfaqësues nga institucionet, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile, është organi i përgjithshëm ekzekutiv. Qeveria vetëm kohët e fundit, në Prill 2017, emëroi një raportues Nacional, i cili është përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave antitrafikim. Qeveria gjithashtu emëroi një koordinator Nacional në Gusht 2017, i cili tani kryeson Komisionin Nacional dhe koordinon përpjekjet antitrafikim. Termet e referimit për Koordinatorin nuk janë gjetur prandaj nuk janë paraqitur në këtë produkt.



Megjithatë, diçka që konsiderohet praktikë e mirë është që Komisioni Nacional në Maqedoni ka formuar një nëngrup për të luftuar trafikimin e fëmijëve në mënyrë që të përballojë sfidat e trafikimit të fëmijëve në drejtim të parandalimit, mbrojtjes dhe ndjekjes penale. Grupe të ngjashme janë formuluar në rastin e Kosovës në të kaluarën, por rezultatet/ndikimet e tyre nuk janë konsideruar shumë relevante dhe efektive.

Grupi i punës përbëhet nga institucione shtetërore si Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Avokati i Popullit, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile.

Gjithashtu, komisioni ka themeluar tre komisione lokale kundër trafikimit, në tri vende të ndryshme në Maqedoni. Këto komisione lokale kanë planet e tyre lokale të veprimit për anti-trafikimin dhe raportojnë në mënyrë periodike tek Komisioni Nacional për zbatimin e tyre. Raportet dhe vlerësimet nuk vihen në dispozicion të publikut.

Themelimi i komisioneve lokale antitrafikim konsiderohet një praktikë e mirë që mund të merret në konsideratë nga ZKNAT në Kosovë. Përndryshe, Mekanizmat Kundër Trafikimit në Kosovë konsiderohen më të avancuara se në Maqedoni.

### c. Serbia

Mekanizmi Nacional i Referimit në Serbi u përcaktua kryesisht nga Strategjia për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe nga marrëveshjet e ndërsjella të akterëve relevantë. Mekanizmi përbëhet nga dy nivele - strategjik dhe operacional.

Niveli strategjik përbëhet nga: Këshilli për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, i themeluar nga Qeveria e Serbisë dhe përbëhet nga niveli i Ministrave të ministrive përkatëse. Këshilli koordinon të gjitha aktivitetet Nacionale dhe rajonale në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, shqyrton raportet e organeve përkatëse të bashkësisë ndërkombëtare, opinionet dhe propozon masa për zbatimin e rekomandimeve të marra nga organet ndërkombëtare. Koordinatori Nacional për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore u emërua në vitin 2002 dhe kryeson Bordin Këshillëdhënës të Republikës për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Ky bord u krijua në vitin 2004 dhe përbëhet nga koordinatori Nacional me bashkëpunëtorët e tij, kryetarët e grupeve të ekipit Nacional dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare.

Niveli operativ përfshin organet gjyqësore dhe policinë, agjencinë për koordinimin e mbrojtjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, qendrat për punë sociale, organizatat e specializuara joqeveritare dhe ndërkombëtare. Agjencia për koordinimin e mbrojtjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është qendra koordinuese e Mekanizmit Nacional të Referimit.

Veprimi në dy nivele konsiderohet një praktikë e mirë që mund të merret parasysh nga ZKNAT.

## 4. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Kosova ka zhvilluar një numër të qasjeve të politikave për luftimin e trafikimit duke përfshirë emërimin e Koordinatorit Nacional Anti-Trafikim në vitin 2008, i parashikuar gjithashtu për të vepruar si Raportues Nacional kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Deri më sot, Qeveria e Kosovës caktoi zëvendësministrat e Punëve të Brendshme si Koordinator Nacional. Kjo kërkesë fillimisht ishte paraparë në kuadër të Strategjisë së Parë të Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2011. Ligji mbi Anti-Trafikimin më tej thekson se emërimi i Koordinatorit duhet të vijë nga qeveria, me Sekretariatit Nacional të Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjive Nationale që vepron nën Ministrinë e Punëve të Brendshme. Shtrirja e përgjegjësisë të saj përfshin kryesimin e Autoritetit Nacional kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe sigurimin e zbatimit të Mekanizmave Nacional të Referimit

Mandati i KNAT/ZKNAT është përshkruar me Ligj dhe në këtë pikë është e vështirë të ndryshohet; ka disa mangësi të identifikuar edhe nga vetë zyra të cilat mund të jemi në gjendje ti trajtojmë për të siguruar një funksionim më të lehtë të Zyrës dhe si rezultat të mbështesim zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër TQNJ.

Shumë nga detyrat e ngarkuara për KNAT kërkojnë njohuri dhe shkathtësi që mund t'i atribuohen një profili profesional me arsimim të dëshmuar dhe përvojë në fushën e Antitrafikimit, domethënë detyrat që kanë të bëjnë me aftësinë për të analizuar situatën dhe nevojat për të informuar mbi Strategjinë, analizën e veprimeve dhe ndikimin e tyre, identifikimin e praktikave më të mira, monitorimin e zbatimit të praktikave, etj.

Vlerësimi i mëparshëm i kryer nga KMOP mbi vlerësimin e nevojave për trajnim të ZKNAT, zbuloi se Koordinatorit Nacional dhe ekipit të tij, edhe pse të ngarkuar me hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AT ju nevojiten njohuri dhe aftësi të mëtjshme në zhvillimin dhe planifikimin e strategjisë. Në të njëjtën kohë, pasi që një nga detyrat kryesore të zyrës është monitorimi, vlerësimi dhe përgatitja e analizave të të dhënave dhe raporteve analitike, me vështirësitë me të cilat aktualisht ballafaqohet në monitorimin e zbatimit të strategjisë, veçanërisht për vlerësimin periodik të arritjes së objektivave dhe rezultateve, ata kanë nevojë për kualifikime të mëtjshme për të qenë në gjendje të kryejnë me sukses këto detyra. E njëjta gjë është identifikuar për koordinimin e veprimeve me palët e interesuara.

Megjithëse janë ndërmarrë shumë përpjekje për të siguruar ngritjen e kapaciteteve të ZKNAT-it, veprimet nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe kjo është pjesërisht për shkak të pozicionit të KNAT që ka ndryshuar për shkak të ndryshimeve në qeverisjen e Kosovës, por edhe për shkak të një numri të madh të detyrave të cilat i caktohen një grupi të vogël njerëzish që punojnë në ZKNAT.

Duke parë strukturën dhe funksionimin e zyrave AT në rajon, rekomandohet:

## FUNKSIONIMI I BRENDSHËM

- Për qëllime të kuptimit të përbashkët të detyrave dhe përgjegjësive të ZKNAT, një rregullore e brendshme ose udhëzim "Si -Të" është hartuar nga ZKNAT (duke përdorur edhe rekomandimet e dhëna në tabelën e mësipërme si dhe në këtë seksion). Kjo rregullore ose udhëzues duhet të përcaktojë qartë se çfarë përcakton secili nen, se si mund të bëhet kjo dhe se si të shpërndajë më mirë detyrat dhe përgjegjësitë brenda Sekretariatit.
- Do të ishte e këshillueshme që struktura e rregullores të ndjek një logjikë që zbërthen detyrat që dalin nga secili nga nenet 8.4 në Ligj, duke shpjeguar mënyrat se si mund të ndërmerren detyrat (duke përfshirë llojin dhe frekuencën e aktiviteteve). Rekomandohet gjithashtu që rregullorja të përshkruajë një ndarje të detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet anëtarëve të ndryshëm të stafit të Sekretariatit, duke paraqitur gjithashtu profilin e kërkuar profesional dhe përshkrimin e punës.
- Në kuadër të Rregullores së brendshme, gjithashtu rekomandohet që detyrat e KNAT, ZKNAT dhe Autoriteti Nacional të ndahen dhe të mos jenë të përcaktuara në një seksion, siç është tani me nenin 8.3 të Ligjit, për të siguruar transparencën dhe efikasitetin e veprimeve. Neni 7 përcakton qartë përgjegjësitë e Autoritetit Nacional ;
- Një nga detyrat specifike të ZKNAT duhet të jetë të inkurajojë rritjen e transparencës së veprimtarisë së institucioneve shtetërore të përfshira në Strategjinë Nationale kundër Trafikimit, megjithatë pothuajse asnjë informatë nuk gjendet ose nuk është e disponueshme në lidhje me veprimet e ZKNAT. Detyrat specifike për informim dhe komunikim publik duhet ti caktohen një personi të caktuar në ZKNAT për tu siguruar që informata është dhënë për gjendjen aktuale të zbatimit të veprimeve nga Plani Nacional dhe më e rëndësishmja, për të siguruar rritjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj përfituesve, palëve të interesit dhe bartësve të detyrave. Kjo duhet të pasqyrohet edhe në rregulloren e brendshme.

BURIMET NJERËZORE: Pozita e KNAT sikur që është mandatuar nga Ligji i është caktuar zëvendësministrit. Për të siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri në funksionimin e zyrës, rekomandohet që koordinimi dhe raportimi i përgjithshëm të mbeten si detyra të KNAT-së, por gjithashtu duhet emëruar një Drejtor të Zyrës për të marrë përsipër detyrat profesionale. Kjo është një praktikë në Shqipëri dhe sipas faqes së internetit të MPB-së në Shqipëri; përfshirja e kësaj pozite i ka dhënë zyrës një dimension të përmirësuar dhe funksional që ka ndikuar në të gjitha aspektet e koordinimit në luftën kundër TQNJ.

- o Pozita e Drejtorit të zyrës kërkon profilin e punës si në vijim:
  - *Diplomë Master me përvojë minimale të punës prej pesë vjetësh me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore*
  - *Njohuri dhe të kuptuarit e shkëlqyeshëm të çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë legjislacionin, politikat, strategjitë dhe trendet.*
  - *Njohja e shërbimeve sociale, përfitimeve publike dhe sistemit të kujdesit shëndetësor.*
  - *Njohja e funksioneve të organizatave të komunitetit dhe shërbimeve të lidhura me të.*
  - *Shkathësi të shkëlqyera organizative dhe të menaxhimit të dokumentacionit.*
  - *Aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive, si me gojë ashtu edhe me shkrim.*

- o Nëse emërohet një Drejtor shtesë i Zyrës, atëherë përgjegjësitë e KNAT-së sipas propozimit dhe praktikave tona nga rajoni do të ishin:
  - *udhëheq me zbatimin e Strategjisë Nationale dhe Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*
  - *udhëheq dhe koordinon Autoritetin Nacional Antitrafikim (thirrje për takime periodike dhe kryeson takimet)*
  - *ndjek zbatimin e Mekanizmit Nacional të Referimit*
  - *përcjellë dhe i raporton Qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trafikimin*
  - *siguronë që masat antitrafikim janë në përputhje me normat ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të cilat janë paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e tjera përkatëse*
  - *propozon ndryshime legislative ose alokime specifike të fondeve në buxhetin e shtetit.*
  - *bashkëpunon në mënyrë aktive me vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit*
  - *inkurajon rritjen e transparencës së veprimtarisë së institucioneve shtetërore me qëllim të rritjes së vetëdijes*
  - *vepron si Reportues Nacional bazuar në informatat e pranuar nga vlerësimet e tendencave në trafikimin e qenieve njerëzore dhe matjen e rezultateve të veprimeve antitrafikim në bashkëpunim të ngushtë me organizatat relevante të shoqërisë civile aktive në këtë fushë.*
  
- Personeli aktual i ZKNAT-it ka profilet specifike për veprimet specifike të MPB-së, megjithatë duke shikuar në Termet e Referencës së zyrës, do të ishte e këshillueshme që ZKNAT-i t'i kushtojë një pozitë të veçantë një personi përgjegjës për planifikimin strategjik dhe zbatimin e sajë, dhe një përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e veprimeve. Kjo do të mbështeste në masë të madhe KNAT dhe ZKNAT në hartimin e Strategjive Nationale dhe Planeve të Veprimit (duke përfshirë ato në nivel lokal ose specifike për fëmijët) dhe gjithashtu për të menaxhuar mekanizmat për analizimin e të dhënave, monitorimin dhe vlerësimin e veprimeve. Kjo gjithashtu do të sigurojë përmirësim të vendimmarrjes për rëndësinë, efektivitetin dhe cilësinë, menaxhimin më të mirë të performancës dhe raporte më të mira dhe cilësore që do të dorëzohen nga ZKNAT tek Qeveria e Kosovës dhe më gjerë.

STRUKTURA dhe KOORDINIMI: Sikur që praktikrat e mira nga rajoni tregojnë, ZKNAT mund të krijojë një ndarje të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve viktime të trafikimit si një kategori specifike që kërkon vëmendje të veçantë. Secila komunë në Kosovë operon një njësi për mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të Qendrave për Mirëqenie Sociale (si menaxherët e rasteve të bazuar në PSV) që marrin pjesë në rastet e fëmijëve të trafikuar ose fëmijëve në rrezik të trafikimit. Krijimi i mekanizmave të koordinimit midis këtyre njësive dhe ZKNAT mund të përmirësojë në masë të madhe mekanizmat parandaluese dhe mbrojtëse për fëmijët në rrezik.

- ZKNAT-i duhet të krijojë degët rajonale dhe lokale për të mbështetur monitorimin e veprimeve dhe situatën e përgjithshme të AT në vend, si dhe monitorimin e zbatimit të PSV-ve. Kjo do të ishte veçanërisht e dobishme për lehtësimin e mbledhjes së të dhënave, por gjithashtu për rrjedhën e përgjithshme të informatave dhe koordinimin e veprimeve në të gjitha nivelet.

## 5. Referencat

1. Ligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit - Qeveria e Kosovës
2. Strategjia Nacionale kundër Trafikimit 2015-2019
3. Planit Nacional i Veprimit kundër Trafikimit 2015-2019
4. Shqyrtimi i Planit Nacional të Veprimit Antitrafikim 2017
5. Vlerësimi i Shpejtë dhe Dokumenti i Rekomandimeve - KMOP 2017
6. Vlerësimi i sistemit të monitorimit të të drejtave të fëmijëve në Kosovë 2009-2015 - UNICEF
7. Kërkesat e BE-së për Kosovën: lufta kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore - KIPRED 2015
8. Udhëzime për zhvillimin dhe zbatimin e një reagimi gjithëpërfshirës kundër trafikimit - Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit - Vjenë 2006
9. Faqja e internetit e Qeverisë së Shtetit të SHBA-ve - Zyra për monitorimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore- 2017 Raporti i Trafikimit me Persona (Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Kroacia)
10. Ueb-Faqja zyrtare - Qeveria e Shqipërisë
11. Ueb-Faqja zyrtare - Qeveria e Maqedonisë
12. Ueb-Faqja zyrtare - Qeveria e Serbisë